

Mbi Kodin e Punës

9 Maj 2017

A. EHW ngriti **problematikat** në lidhje me:

- b) Nivelin e gjobave të parashikuara në Kodin e Punës duke pretenduar se janë shumë të larta në krahasim edhe me vendet e tjera të rajonit;
- c) Diapazonin e gjerë të gjobave të parashikuara në Kodin e Punës (*deri në 50 fishin e pagës minimale*). Gjobat në mungesë të përcaktimit të qartë të një minimumi, lënë hapësirë të madhe në dispozicion të inspektorëve për vendosjen e tyre dhe krijojnë mundësi për arbitraritet.

B. **Detyra** që u la në mbledhjen e kaluar të KI për Sekretariatin, ishte të analizonte këto pretendime dhe të diskutonte me institucionet përkatëse mbi ndërhyrjet e duhura dhe konkretisht mbi **mundësinë e kufizimit të** diskrecionit të inspektorëve në vendosjen e gjobave.

C. Për sa më sipër Sekretariati kreu **veprimet e mëposhtme**:

- a) Analizoi Kodin e Punës dhe Ligjin “Për Inspektimin e Punës në RSh”.
- b) Analizoi rekomandimet/studimet e ILO për këtë qëllim.
- c) Konsultime dhe takime me inspektorë, Inspektoriatin e Punës dhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

D. Bazuar në sa më lartë ju informojmë si më poshtë vijon:

1. Inspektorët e punës vendosin gjobat/sanksionet bazuar në Ligjin Nr. 9634 datë 30.10.2006 "Për Inspektimin e Punës " (i ndryshuar) dhe Ligjin Nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në RSH". **Mungon një Metodologji konkrete e vendosjes së masave administrative (gjobave), ndërkohë që dhe Kodi i Punës për pjesën më të madhe të shkeljeve nuk përcakton qartësisht një nivel minimum të gjobës së zbatueshme.**

2. Në praktikë masat e gjobave përcaktohen nga inspektorët në mënyrë proporcionale në raport me shkeljet në fushën e punës. Elementet që mbahen në konsideratë nga inspektorët në vendosjen e gjobave janë: a) përsëritja ose jo e e shkeljes; b) kohëzgjatja e shkeljes; c) shkalla e dëmit dhe e pasojave të ardhura; d) numri i të punësuarve të prekur nga shkelja.

3. Aktualisht Inspektoriat Qëndror dhe Inspektoriat i Punës po punojnë për përgatitjen e një Metodologjie “Për Mënyrën e Vendosjes së Masave Administrative/Gjobave” e cila është ende DRAFT. **Kjo Metodologji do të kufizojë diskrecionin e inspektorëve të punës apo mundësinë e vendosjes së gjobave në mënyrë abuzive.** Kjo është parë si masë në kuadrin edhe të projektit *e-inspections* (inspektimi online).

4. Gjithashtu, Ligji Nr. 9634 datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës” u ndryshua së fundi me Ligjin Nr. 57/2017 datë 20.04.2017 i cili pritet **të hyjë në fuqi** brenda muajit Maj 2017. Me këtë Ligj janë bërë saktësime në lidhje me nivelin e gjobave sa i përket kufirit **minimal**, të zbatuara nga inspektorët duke u parashikuar konkretisht: **“inspektori i punës vendos gjobë nga 10 deri në 50-fishin e pagës minimale, sipas parimit të proporcionalitetit, në përputhje me ligjin për inspektimin”**. Gjithashtu me këtë Ligj u bënë dhe një sërë saktësime të tjera të Ligjit në raport me Kodin e Punës.

5. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë na informoi se një nga komentet e ekspertëve të Zyrës Ndërkombëtare të Punës- ILO të bërë që në 2012 lidhej pikërisht me nevojën e përcaktimit të niveleve minimale të gjobave. Kjo do i shërbente efektivitetit të sanksioneve dhe do rriste sigurinë e praktikës ligjore duke i lënë më pak hapësirë diskrecionit të autoriteteve. Ndërkohë që organizatat e punëdhënësve kanë qenë dakord në parim me ndryshimet e tjera në Kodin e Punës që u miratuan në 2015 dhe rezultojnë se janë konsultuar.

E. Konkluzion: Nga Analiza e bërë nga Sekretariati rezultojnë se:

1. Pothuajse të gjitha vendet parashikojnë gjoba në një diapazon të gjerë për shkelje të legjislacionit të punës. Kufizimi i diskrecionit të inspektorëve bëhet me Metodologji dhe Manuale shpjeguese për inspektorët si dhe me kualifikim të tyre.
2. Parashikimi i gjobave fikse për shkeljet e legjislacionit të punës nuk ndihmon në diferencimin e shkeljeve, dëmit/pasojave të ardhura.
3. Tendenca është për rritje të masave administrative (gjobë) dhe forcim edhe të sanksioneve penale në disa vende.
4. **Sekretariati vlerëson se shqetësimi i biznesit lidhur me kufizimin e diskrecionit të inspektorëve të punës në vendimmarrjen e tyre për vendosjen e gjobave, adresohet nëpërmjet:**
 - a) Ndryshimit më të fundit ligjor me Ligjin Nr. 57/2017 që ndryshoi ligjin “Për Inspektimin e Punës”, i cili vendos kufinj të minimalë.
 - b) **Miratimi i Metodologjisë** për mënyrën e vendosjes së masave administrative/penaliteve në bashkëpunim me Inspektoriatin Qëndror.
 - c) **Procedurat e inspektimit on-line** të ndërthurura edhe me trajnime dhe kualifikime të inspektorëve të punës do t'i shërbejë qëllimit për kufizimin e arbitraritetit të mundshëm të inspektorëve në vendosjen e gjobave.